



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1881/6 Prot.

Tiranë, më 21.01 2015

VENDIM

Nr. 05 ,datë 21/01 2015

Bazuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 3 dhe 5/c të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 1881/6, datë 30.12.2014, kundër Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, me objekt “*Refuzim për dhënie informacioni*”.

Në përputhje me pikën 2 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” konstatohet se, ankuesi legjitimohet në depozitim të ankesës së tij. Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ankuesi nëpërmjet shkresës datë 16.12.2014, ka kërkuar nga autoriteti publik/Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, 1) ti vihet në dispozicion lista e të gjithë aplikantëve për staf akademik viti 2014, për të tre Departamentet e Fakultetit të Ekonomisë, Financë, Biznes dhe Ekonomiks 2) ti vihen në dispozicion emrat e pedagogëve që u rekrutuan nga Universiteti për staf të brendshëm Akademik për vitin 2014 të tre Departamenteve të Fakultetit të Ekonomisë si dhe 3) ti vihen në dispozicion procesverbalet e mbajtura gjatë procesit të përzgjedhjes së këtyre kandidatëve nga të tre departamentet e Fakultetit të Ekonomisë.

Nga shqyrtimi i praktikës rezulton se, Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë me shkresën nr. 683/1 prot, datë 24.12.2014 ka kthyer përgjigje kërkesës së ankuesit, duke refuzuar dhënien e dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 dhe 3 të ankesës/kërkesës, nën arsyetimin se, emrat e aplikantëve për staf akademik dhe procesverbalet e mbajtura gjatë procesit të përzgjedhjes së tyre trajtohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nenet 3/1, 5 dhe 6 të këtij ligji, ndërsa në përmbushje të pikës 2 të kërkesës/ankesës, Universiteti bën me dije ankuesin se, emrat e pedagogëve të rekrutuar prej tij/Universitetit për të gjitha fakultetet dhe departamentet janë publik dhe mund të konsultohen online në faqen zyrtare të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

Ankuesi i bazon pretendimet e tij në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në përputhje me të cilin kërkon të detyrohet autoriteti publik/Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, për të dhënë informacionin e kërkuar si dhe kërkon penalizmin e Universitetit pasi, me mosdhënien e informacionit ka mohuar të drejtën e tij të garantuar nga ligji në kohën e parashikuar.

Komisioneri konstaton se, kjo bazueshmëri ligjore e përdorur në ankesë kërkon detyrimin e

autoriteteve publike të bëjnë publik informacionin pa kërkesë dhe jo detyrimin e tyre për të dhënë informacionin e kërkuar. Përmbushja e objektit të ankesës së ankuesit nuk është në përputhje me bazueshmërinë ligjore të përdorur. Informacioni që bëhet publik nga çdo autoritet, i jep mundësinë individit të informohet nëpërmjet faqes zyrtare të çdo autoriteti/në këtë rast Usniversitetit. Nën këtë referencë ligjore Universiteti ka orientuar ankuesin të njihet me njërin prej informacioneve të cilin e ka bërë publik pasi e ka vlerësuar të tillë në përputhje me dispozitën ligjore përkatëse.

Nga ana tjetër Universiteti ka refuzuar dhënien e pjesës tjetër të informacionit nën arsyetimin e nenit 3/1/5 dhe 6 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, duke parashtruar se, dokumentacioni përmban të dhëna personale. Në vlerësim të ankesës dhe parashtrimeve të autoritetit publik/Universitetit, Komisioneri konstaton se në këtë rast mbajtja e të dhënave personale (në mbajtje përfshihet edhe koha e ruajtjes së tyre) realizohet në përputhje me qëllimin e mbledhjes së tyre si dhe për aq kohë sa përfundon qëllimi. Të dhënat personale të subjekteve të të dhënave duhet të përpunohen nga kontrolluesi/Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 5 dhe 6 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, çka nënkupton se kontrolluesi/Universiteti është i detyruar që pas përfundimit të procedurave të përzgjedhjes së kandidataturave, përfundimit të fazës së ankimeve të bëra nga kandidatët, etj, të shkatërrojë të dhënat personale. Ndërsa, në përputhje me shkronjën "d" të nenit 5 të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, autoriteti publik (gjithnjë si kontrollues i të dhënave) detyrohet të mbajë ato/të dhënat (nëse e vlerëson) në atë formë që, pas përfundimit të qëllimit për të cilin ato janë mbledhur të mos arrihet, lejohet identifikimi i subjekteve. Kur informacioni përmban të dhëna personale (siç është rasti), kërkuesi i tij, pra individ i cili kërkon informacionin/dokumentacionin legjitimohet dhe pajiset me të duke përcaktuar lidhjen e tij me të dhënat personale me një nga mënyrat e parashikuara në legjislacion. Pra, kërkuesit/individit ose i përkasin të dhënat personale në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe mund të pajiset me dokumentacionin që i përmban ato, ose i kërkon ato si përfaqësues ligjor, ose me pëlqimin e vetë individit që i përkasin të dhënat personale.

Gjithashtu, shkronja "d" e nenit 7 të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" përcakton kategorinë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe më konkretisht të dhënat mbi arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve të cilët kanë detyrim për deklarim të pasurisë sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë si dhe një përshkrim i procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik...Kjo referencë ligjore saktëson që për çdo informacion tjetër të papërfshirë në këtë kategori, domosdoshmërisht duhet bërë balanca midis lejimit dhe ndalimit të dhënies së informacionit në përputhje me ligjet respektive për të drejtën informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Bërjes së kësaj balance i nënshtrohen në rastin objekt shqyrtimi edhe procesverbalet e kërkuara nga ankuesi.

Në përfundim, konstatohet se, balanca e bërë nga autoriteti publik/Universiteti "Ismail Qemali" në mënyrë të përmbledhur në përgjigjen e dhënë ankuesit është e bazuar në ligj e ndërsa, objekti i ankesës nuk përputhet me bazën ligjore dhe si e tillë ajo nuk pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në pikën 5/c të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", nenin 31/1 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

**V E N D O S A:**

1. Rrëzimin e ankesës nr 1881/6, datë 30.12.2014, të ankuesit Z.

Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë të ankohen pranë Gjykatës Administrative kompetente në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Ky vendim u dha sot në datë 21.01.2015.

